



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1725 Prot.

Durrës, më, 16/11 /2022

V E N D I M

Nr. 68 Datë 16/11 2022

"Për ndryshime në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në Fakultetin e Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës në programin e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit sportit dhe Rinisë nr. 7 datë 31.03.2021, pika 2/F/Id " për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020, bazuar në shkresën e Fakultetit të Biznesit nr. 786 prot datë 15.11.2022, të vendimit të Senatit Akademik Nr. 23 datë 24.09.2020. Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Ndryshimet në kapacitetet akademike nga momenti i riorganizimit të programit të ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" në Fakultetin e Biznesit janë si me poshtë:
 - Në Departamentin e Menaxhimit 1(nje) shtesë staf akademik me titull Prof.Dr.
 - Në Departamentin e Shkencave Ekonomike 1(nje) shtesë staf akademik me titull Prof.As.Dr.
 - Në Departamentin e Financë Kontabilitetit 1(nje) shtesë staf akademik me titull Prof.Dr.
2. Ndryshime në Kapacitete Infrastrukturore si :
 - Ndërtimi i një laborator për Kërkim Shkencor në funksion të studimeve të Doktoraturës pranë Fakultetit të Biznesit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Zv.Rektoret,
 - Administratori,
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof.Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU
FAKULTETI I BIZNESIT

Nr. 186 prot

Durrës, më 15.11.2022

Lënda: Përcillet dokumentacioni referuar Udhëzimit të MASR, Nr.7, datë 31.3.2021, pika 2/F/1d

KRYETAR SENATI, Prof.Dr. Kscanela SOTIROFSKI
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU"

Durrës

E nderuar,

Bazuar në Udhëzimin e MASR, Nr.7, datë 31.3.2021, "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, referuar pikës 2/F, "Dokumentacioni dhe procedura për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pas miratimit për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit të Ciklit të Tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", pika 1/d, "Ndryshimet në kapacitetet akademike dhe infrastrukturore për përfshirjen në përfshirjen në programet e studimit të doktoratës që nga momenti i hapjes/riorganizimit të programit", si dhe bazuar në pikën 1/a, "Vendimin e Senatit Akademik për përcaktimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për programet e studimit të ciklit të tretë, për fitimin e gradës shkencore "Doktor", bashkëngjitur gjeni :

1- Ndryshimet në kapacitetet akademike për Fakultetin e Biznesit.

	Titulli	Marketing	Menaxhim	Financë Kontabilitet	Shkenca Ekonomike	Totali	Doktorantë
PAE	Profesor	0	1	2	2	5	15
	Prof.As.	6	3	0	2	11	22

Aktualisht janë të miratuara nga MASR, 25 kuota (për të gjithë ciklin), bazuar në shkresën me 1453 Prot, datë 4.3.2022.

Ndryshimet në kapacitetet akademike nga momenti i riorganizimit të programit të Ciklit të Tretë të studimeve, Doktoratë në Shkenca Ekonomike, janë si më poshtë :

1(një) shtesë Prof. Dr në Departamentin e Menaxhimit, 1(një) shtesë Prof. Asoc. Dr. në Departamentin e Shkencave Ekonomike dhe 1(një) Prof. Asoc. Dr ka marrë titullin Prof. Dr në Departamentin e Financë Kontabilitetit.

2- Ndryshimet në kapacitetet infrastrukturore

Në funksion të programit të Ciklit të Tretë të studimeve Doktoratë në "Shkenca Ekonomike" është ndërtimi i laboratorit për kërkimin shkencor projekt i cili është miratuar për financim në bashkëpunim me AKKSHI-n (Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit), "Ndërtimi i një laboratorit për kërkimin shkencor në funksion të studimeve të doktoraturës, pranë Fakultetit të Biznesit".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DEKAN
Prof. Dr. Shkëlqim FORUZI

